

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“E.F.I.H” SHPK**

Ortaku themelues z. Ervis Fatmir Kau, shtetas shqiptar, i datëlindjes 09.11.1988, lindur Kruje dhe banues në Kruje, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. I81109087R, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 20.02.2023, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon:

**NENI 1**

***Emri***

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “E.F.I.H”.  
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**

***Forma***

Shoqëria tregtare “E.F.I.H”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

***Zyra Qendrore***

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “E.F.I.H” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Fier Ballsh BALLSH Rruga Ballsh-Aranitas, Zona Kadastrale 3192, Nr Pasurie 83/5.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**

***Objekti i Veprimtarisë***

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është:

Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrial, lëkur, tekstile dhe prodhime të tyre. Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë, këpucësh, faqe këpucësh, për llogari të vet dhe për të tretë. Tregtimi dhe përpunimi i veshjeve dhe rrobave të punës, për

vete dhe për të tretë (fasoneri), si dhe blerje - shitje të makinerive të përpunimit e prodhimit të lëkurës, pëlhurës dhe të tekstileve. Transport brenda vendit dhe ndërkombëtar për vete dhe të tretë. Prerje, qepje e prodhim të këpucëve, çantave, rrypave apo veshjeve të lëkurës. Tregëti me shumicë dhe me pakicë edhe on-line, prodhimin, importimin dhe eksportimin, shpërndarjen me dhe/ose pa magazinë si kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe me marrjen e mandateve të perfaqësisë me dhe/ose pa magazinë, te artikujve ushqimore, të veshmbathjeve të çfarëdo lloj përbërje dhe vlere, përfshirë bluze dhe këmishi të jashtme, aksesore për veshje të çfarëdo lloj materiali, këpucë, veshmbathje lëkure, copa të çfarëdo lloj materiali, fije dhe aksesore rrobaqepësie, paisje dhe artikuj sportive, parfume, kosmetike, bizhuteri, artikuj për dhurata, kancelari, produkte tekstile të çfarëdo lloji dhe materiali përfshirë ato të arredimit të shtëpive dhe për kujdesin e higjenën personale apo të kafshëve. Shoqëria mundet gjithashtu të përftojë dhe marrë shpërndarjen me franchising, pra të ketë të drejtë të shpërndajë markat e saj eventuale dhe dijen dhe eksperiencën e saj (know-how) në franchising, të bëjë çfarëdo lloj aktiviteti të përshtatshëm dhe të lidhur me çfarë është përmendur me lart brenda limiteve ligjore. Mundet të blejë ose marrë me qera dhe mund të marrë përsipër në mënyrë direkte ose indirekte interesat dhe pjesëmarrjet në shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm

#### **NENI 5**

#### ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

#### **NENI 6**

#### ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare "E.F.I.H" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### **NENI 7**

#### ***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "E.F.I.H" SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

#### **NENI 8**

#### ***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "E.F.I.H" SHPK është 10.000 (dhjetëmijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët i vetëm i shoqërisë.

8.2 Ortaku i vetëm i shoqërisë është zotëron 100% të kuotave të kapitalit në vlerën 10,000 (dhjetëmijë) lekë.

**NENI 9**  
***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**  
***Administratori***

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është **Z. Ervis Kau**

**NENI 11**  
***Sekreti tregtar***

Ortaku, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “E.F.I.H” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

**ORTAKU THEMELUES**

**Ervis Kau**

